

VENDIM
Nr. 223, datë 11.3.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 177, DATË 26.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN, PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR ADMINISTRIMIN E UJËRAVE NDËRKUFITARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 177, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2, fjalët “...zëvendësministri i Mjedisit...” zëvendësohen me “...zëvendës-ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave...” dhe në fund shtohen nënndarjet, si vijon:

“- ministri i Shtetit për Çështjet Vendore;

- Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.”

2. Në pikën 3, fjalët “Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit...” zëvendësohen me “Drejtoria përgjegjëse për administrimin e ujërave, në ministrinë përgjegjëse për fushën e ujërave...”

3. Në pikën 5, fjalët “...ministrit të Mjedisit...” zëvendësohen me “...ministrit përgjegjës për fushën e ujërave ...”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama